



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 39/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

| | |
|---------------|------------|
| Evis Shurdha | Kryetar |
| Enkeleda Bega | Nënkryetar |
| Vilma Zhupaj | Anëtar |
| Lindita Skeja | Anëtar |
| Merita Zeqaj | Anëtar |

Në mbledhjen e datës 27.01.2020, shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e shoqërisë “Erald-G” sh.p.k në procedurën e prokurimit me Nr.REF-44482-11-21-2019, me objekt: “*Supervizion punimesh ndërtim i Urës së Zemblakut, Urës së Kaludhit, Urës së Dragotit, Urës së Leksit*”, me fond limit 1.738.185,65 lekë pa tvsh, zhvilluar ne daten 03.12.2019 nga autoriteti kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Ankimues: BOE “D&C Partners” sh.p.k & “Net-Group” sh.p.k
Rr. “Urani Pano”, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Autoriteti Rrugor Shqiptar.
Rr. “Sami Frashëri”, Nr.33, Tiranë

Subjekte të Interesuar: “Erlad-G” sh.p.k
Diber Maqellare HERBEL Zyra në katin e parë, banesa 2- katëshe në lindje të fshatit herbel, Komuna Maqellarë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 22.11.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit me Nr.REF-44482-11-21-2019, me objekt: “Supervizion punimesh ndërtim i Urës së Zemblakut, Urës së Kaludhit, Urës së Dragotit, Urës së Leksit”, me fond limit 1.738.185,65 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 03.12.2019 nga autoriteti kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar.

II.2. Në datën 10.12.2019 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht për klasifikimin përfundimtar të ofertave dhe ofertuesit e skualifikuar si më poshtë:

- | | | |
|----|--------------------------|--------------------------------|
| 1. | “Erlad-G” sh.p.k | 1.474.475,00 lekë, kualifikuar |
| 2. | “A&E Engineering” sh.p.k | 1.549.042,07 lekë, kualifikuar |
| 3. | “D&C Partners” sh.p.k | 1.549.042,07 lekë, kualifikuar |
| 4. | “He&Sk 11” sh.p.k | 1.549.042,07 lekë, kualifikuar |
| 5. | “Derbi - E” sh.p.k | 1.580.000,00 lekë, kualifikuar |

6. "PNI-2001" sh.p.k

1.650.000,00 lekë, kualifikuar

II.3. Në datën 16.12.2019, BOE ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, nëpërmjet të cilës kundërshton kualifikimin e shoqërisë "Erald-G" sh.p.k në procedurën e prokurimit. Konkretisht pretendohet si vijon:

"Operatori i renditur i pari me cmimin me te ulet: "Erald-G"shpk, sipas llogaritjeve te bera nga ana jone per vleren minimale te lejuar, ka ofertuar nen vleren minimale te lejuar per oferten ekonomike.[...] Autoriteti kontraktor sqaron qe ne per llogaritjen e fondit limit eshte bazuar ne VKM nr. 354, date 11.05.2016 "Per miratimin e manualit te tarifave per sherbime ne planifikim territori, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim" dhe thekson se objekti klasifikohet ne grupin II tarifar. Vleresimi i ofertave eshte kryer duke mos aplikuar formulen per oferten anomalisht te ulet, referuar ligjit per prokurimin publik, por i eshte referuar vlerave minimale, pasi ofertuesi "Erald-G" shpk ka paraqitur nje oferte te papergjegjshme dhe nen kufirin e percaktuar nga legjislacioni i posacem ne fuqi "Per miratimin e manualit te tarifave per sherbime ne planifikim territori, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim," e cila eshte e detyrueshme per te gjitha operatoret ekonomike, pasi ky legjislacion nuk le ne diskrecionin e nje autoriteti kontraktor te pranoje argumentat per elementet e vecante te ofertes ekonomike te operatoreve, persa kohe qe ajo eshte jashte kufijve minimale dhe maksimale te tarifave."

II.4. Nëpërmjet shkresës nr. 11471/3 prot., datë 20.12.2019 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimuesit duke e refuzuar ankesën si më poshtë:

Procedura e prokurimit me objekt "Supervizion punimesh Ndertim i Ures se Zemblakut, Ures se Kaludhit, Ures se Dragotit, Ures se Leklit ", eshte publikuar ne faqen e APP-se me date 22.11.2019. Hapja e ofertave eshte bere me date 10.12.2019. Komisioni i Vleresirnit te Ofertave (KVO) ka kryer shqyrtimin e ofertave dhe ka dale ne konkluzionin qe te 6 operatoret/bashkimet e operatoreve ekonomike i plotesojne kerkesat per kualifikim.

Verejme se, ne DST-te e hartuara dhe te publikuara per kete procedure prokurimi, ne Shtojcen I "Formulari i ofertes ekonomike" dhe ne kriteret e vecanta ishte kerkuar qe:

"Operatoret ekonomike ne pergatitjen e ofertes se tyre duhet t'i referohen VKM nr. 354. date I 1.05.2016 "Per miratimin e manualit te tarifave per sherbime ne planifikim territori, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim ". Objekti urat perfshihet ne grupin e II tarifar".

Rezulton se me date 06.12.2019, KVO i eshte drejtuar operatorit qe ka ofruar vleren me te ulet "Erald-G shpk" me shkresen "Kerkese per argumentim", sipas se ciles kerkohet sqarim nese ne pergatitjen e ofertes i eshte referuar VKM-se nr.354 date 11.05.2016 dhe argumentim i per llogaritjes se ofertes. Kjo kerkese ka mbeshtetje ligjore pasi, ne nenin 53 te Ligjit nr.9643 date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik" i ndryshuar, pika I parashikon: "Autoriteti kontraktor, kur e shikon te arsyeshme, u kerkon ofertuesve sqarime per ofertat e tyre, per shqyrtimin, vleresimin dhe krahasimin sa me te drejte te ketyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara ne nenet 32 dhe 33 te ketij ligji, nuk duhet te kerkohet, ofrohet apo lejohet asnje ndryshim ne permbajtjen e ofertes, perfshire ndryshimet ne cmim apo ndryshime qe synojne te kthejne nje oferte te pavlefshme ne te vlefshme".

Konstatohet se, me datë 10.12.2019 operatori ekonomik që ka ofruar vlerën me të ulët "Erald-G shpk", ka paraqitur shkresën nr.11168 ku paraqet sqarimin se oferta është hartuar referuar VKM-se nr.354 datë 11.05.2016 "Per miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim", bazuar në seksionin IV, strukturat e transportit dhe qarkullimit, tabela 12, grupi 11 tarifor, mbikëqyrja 25% dhe referuar termat e referencës për procedurën. Gjithashtu ka paraqitur kostot e llogaritshme dhe vlerat për secilën nga urat që janë objekt mbikëqyrjeje.

Rezultoni se KVO ka pranuar sqarimet e operatorit ekonomik Erald-G shpk, i cili sipas procesverbalit të vlerësimit (nr.3) datë 10.12.2019 klasifikohet i pari në renditjen e operatoreve të kualifikuar për procedurën e prokurimit në fjalë.

Referuar pretendimeve të ankimesit, arsyetohet se:

- Pretendimi se operatori i renditur i pari ka ofertuar në vlerën minimale të lejuar për ofertën ekonomike nuk gjendet i bazuar, përkundrazi se pari sepse referuar DST-ve të shpallura nga ARRSH në sistemin elektronik, nuk rezultoi që të jetë publikuar vlera minimale e lejuar për ofertën ekonomike (sipas rekomandimit të APP, të cituar nga ankimesi), por vetëm vlera e fondit limit që është 1.738.185,65 leke pa TVSH.

Se dyti, as vete ankimesi nuk ka paraqitur një llogaritje të tijen sipas se çiles të rezultojë se vlera e ofertuar nga i klasifikuari në vendin e parë është e përlogaritur jo konform VKM-se nr.354 datë 11.05.2016. Citimi i parimeve të përgjithshme rreth rendesise së kësaj VKM-je, i nënve të saj apo rekomandimit të APP-se nuk justifikon mungesën e fakteve apo të llogaritjes konkrete të vlerës së kontestuar nga ana e ankimesit.

KVO nuk ka aplikuar formulën apo me të njëjtën hapat vijues për ofertën anomalisht të ulët, pasi referuar legjislacionit për prokurimin publik dhe ofertave të paraqitura nuk jemi në kushtet e aplikimit të saj pasi vlera me të ulët e ofruar nuk rezultoi anomalisht e ulët.

KVO ka i ka kerkuar ofertuesit të vlerës me të ulët sqarime për ofertën bazuar në nenin 53 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik" i ndryshuar.

Komisioni i shqyrtimit të ankesës së fundmi, i sjell në vëmendje ankimesit se autoriteti kontraktor zhvillon procedurat e prokurimit në respektim rigoroz të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik" i ndryshuar, i cili në nenin 1 të tij përcakton se qëllimi i kësaj ligji është të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike si dhe Rekomandimeve të vazhdueshme të KLSH-se në raportet e saj pas auditave të ushtruara se, në vlerësimin e ofertave autoriteti kontraktor duhet të parandalojë demin ekonomik duke skualifikuar pa të drejtë ofertat me të ulët.

Në bazë të nenit 63 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", i ndryshuar, dhe nenit 78 të VKM-se nr.914 datë 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave të prokurimit publik" e ndryshuar dhe mbështetur në arsyetimin e mesipër, Komisioni për shqyrtimin e ankesës, vendosi të mos pranojë ankesën e paraqitur nga "D&C Partners shpk".

II.5. Në datën 27.12.2019 BOE "D&C Partners" sh.p.k & "Net-Group" sh.p.k ankimes ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt si edhe në autoritetin kontraktor.

II.6. Në datën 13.01.2020 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1947/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 17/1 prot., datë 08.01.2020, bashkëngjitur informacioni e dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e BOE “D&C Partners” sh.p.k & “Net-Group” sh.p.k për kundërshtimin e kualifikimit të shoqërisë “Erald-G” sh.p.k me arsyetimin se *“Operatori i renditur i pari me cmimin me te ulet: "Erald-G" shpk, sipas llogaritjeve te bera nga ana jone per vleren minimale te lejuar, ka ofertuar nen vleren minimale te lejuar per oferten ekonomike[...]”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në Shtojcën e ngrakuar në SPE “Termet e Referencës”, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar: *“Me fondet nga buxheti të shtetit për vitin 2019 dhe 2020 janë parashikuar të kryhen mbikëqyrja e punimeve në objektin “ Rikonstruksioni i Urave të Kaludhit, Dragotit dhe Leklit; Ndërtimi i Urës së Zëmbllakut” me vlerë për mbikëqyrje punimesh prej: 1 738 185,65 lekë (pa TVSH), grupi i dytë tarifor sipas vendimit të Këshillit të Ministrave Nr 354, datë 11.05.2016 “Përmiratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim , mbikëqyrje dhe kolaudim.””*

III.1.2. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor me shkresën nr. 17/1 prot, datë 08.01.2020 protokolluar me tonën me nr 1947/2 prot., datë 13.01.2020, KPP konstaton se përlllogaritja e fondit limit për procedurën e prokurimit objekt ankimi, nga ky i fundit është bërë, bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 *“Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”*.

III.1.3. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 *“Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”* sipërcituar në nenin 1 të tij *“Fusha e Veprimt”* parashikon shprehimisht se: *Ky manual i tarifave vlen për llogaritjen e pagesave për të gjitha shërbimet e palnifikimit, projektimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të kryera nga arkitektët dhe inxhinierët (porosimarrës) të financuara me fonde publike, të financuara me fonde publike, të përfshira në listën e punimeve të këtij manuali.*

Ndërsa në nenin 7 të saj parashikohet shprehimisht se: *Tarifat për shërbimet duhet të jenë në një vlerë ndërmjet tarifave minimale dhe maksimale të përcaktuara në këtë manual në përputhje me LPP. Pika 3 e nenit 7 parashikon se: Në rrethana të jashtëzakonshme dhe nëse dokumentohet me shkrim tarifat edhe mund të jenë më të ulëta se sa tarifa minimale të specifikuara nga ky manual.*

III.1.4. Në Rekomandimin Nr. 5585 Prot datë 25.07.2017 të APP-së; *“Rekomandim mbi menyren e percaktimit te tarifave minimale te specifikuara ne Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr.354,*

datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave per sherbime ne planifikim territori, projektim, mbikeqyerje dhe kolaudim", parashikohet si më poshtë:

- *Per sherbimet e parashikuara ne vendimin e sipercituar (Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr.354, datë 11.05.2016), APP rekomandon qe, krahas perlllogaritjes se fondit limit (i cili perlllogaritet nisur nga perqindja maksimale e lejuar), behet perlllogaritja e vleres minimale te lejuar (e cila perlllogaritet nisur nga p erqindja minimale e lejuar), ne varesi te kategorise dhe grupit tarifor , ku ben pjese objekti i prokurimit*
- *Ne nenin 7, pika 3, te vendimit te sipercituar, parashikohet se: "Ne rrethana te jashtezakonshme dhe nese dokumentohet me shkrim, tarifat edhe mund te jene me te uleta sesa normat minimale, te specifikuara nga ky manual".*
- *Ne kete kontekst rekomandojme qe, ne rastet kur nuk dokurnentohet rrethana e jashtezakonshme, autoritetet kontraktore gjate vleresimit te ofertave, duhet t'i referohen vleres minimale te perlllogaritur per secilin rast, ne haze te parashikimeve ne VKM Nr. 354, date 11.05.2016 "Per miratimin e manualit te tarifave per sherbime ne planifikim territori, projektim, mbikeqyrje edhe kolaudim".*
- *Ne paraqitjen e ofertave ne kete lloj procedure prokurimi, operatoret ekonomike duhet te mbajne ne konsiderate edhe vlerat minimale te perlllogaritura nga autoritetet kontraktore ne zbatim te VKM Nr. 354, date 11.05.2016 "Per miratimin e manualit te tarifave per sherbime ne planifikim territori, projektim, mbikeqyrje edhe kolaudim".*

III.1.5. Komisioni i Prokurimit Publik, në rastin konkret, nisur nga informacioni dhe dokumentacioni i detajuar i dhënë nga autoriteti kontraktor, kryesisht në lidhje me përlllogaritjen e fondit limit, konstaton se, nga ky i fundit janë bërë përlllogaritjet edhe për përcaktimin e vlerave minimale e maksimale të mbikëqyrjes, duke u bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 *"Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim"*. Pra vetë autoriteti kontraktor si organi përgjegjës për zhvillimin e procedurës së prokurimit ka përcaktuar detaje për përcaktimin e fondit limit, të cilat vinë në përmbushje të legjislacionit përkatës në fuqi.

Qëllimi i VKM nr. 354, datë 11.05.2016 *"Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim"* është që të mbrojë profesionet të cilat merren me planifikim territori, projektim, mbikëqyrje e kolaudim, pra lidhet me punën intelektuale që do të bëhen, duke dhënë një punë cilësore, por me një vlerë mbi minimumin e lejuar të përcaktuar me një vendim të posaçëm; Kjo VKM e posaçme ka për qëllim të zgjidhë situatën e vështirë të krijuar në afrimin dhe përzgjedhjen e personave fizikë, apo juridikë të interesuar, të kontraktohen për shërbimet e kërkuara, pasi shpesh ka rezultuar edhe me uljen e cilësisë së shërbimit të ofruar; Efekti i zbatimit të kësaj VKM është rritja e cilësisë së produktit të marrë në fushën e studimit, projektimit, drejtimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit, nëpërmjet afrimit të profesionistëve të dalluar, duke përfruar nivelin e pagave që ato t'i përgjigjen realitetit të tregut të sotëm;

Gjithashtu, referuar edhe frymës së legjislacionit të posaçëm në fuqi, në rast se nuk zbatohet kjo VKM e cila ka dalë për qëllim të posaçëm për të mbrojtur punën intelektualë që bëhet në fushën e këtyre shërbimeve, atëherë kjo VKM nuk ka më asnjë vlerë dhe do të humbiste qëllimin për të cilin ka dalë për zbatim, sepse vetëm nëse do të mbeteshim tek argumentimi i analizës së kostos

nëse ajo do të rezultonte anomalisht e ulët, atëherë kjo analizë do të ishte shumë subjektive, aq më tepër kur autoriteti kontraktor mund të kërkonte sqarime nga operatorët ekonomikë nëse pas aplikimit të formulës për ofertën anomalisht të ulët, mbi ofertat brenda kufijve ligjorë, do të rezultonte se një apo më shumë oferta janë anomalisht të ulta.

Autoriteti kontraktor sqaron se ai që në përlllogaritjen e fondit limit është bazuar në VKM nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, vlerësimi i ofertave është kryer duke aplikuar formulën për ofertën anomalisht të ulët referuar ligjit për prokurimin publik, dhe jo vlerave minimale, ndërkohë që shoqëria “Erald-G” sh.p.k ka paraqitur ofertë nën kufirin e përcaktuar nga legjislacioni i posaçëm në fuqi “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, e cila është e detyrueshme për të gjithë operatorët ekonomikë, pasi ky legjislacion nuk lë në diskrecionin e një autoriteti kontraktor të pranojë argumentat për elementët e veçantë të ofertës ekonomike të operatorëve, përse kohë që ajo është jashtë kufijve minimalë dhe maksimalë të tarifave.

Sa më sipër, oferta e paraqitur nga shoqëria “Erald-G” sh.p.k nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

III.1.6. Referuar shkresës nr. 17/1 prot, datë 08.01.2020 të autoritetit kontraktor dhe dokumentacionit bashkëngjitur kësaj shkrese rezulton se vlera minimale e *supervizionit të punimeve ndërtim i Urës së Zemblakut, Urës së Kaludhit, Urës së Dragotit, Urës së Leksit* është në vlerën 1.549.042,07 lekë pa tvsh. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ofertës ekonomike të shoqërisë “Erald-G” sh.p.k rezulton se ka ofertuar për realizimin e kontratës objekt prokurimi përkatësisht me vlerën 1.474.475,00 lekë pa tvsh. KPP gjykon se vlera e ofertuar nga shoqëria “Erald-G” sh.p.k nuk është në përputhje me VKM nr. Nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, dhe rekomandimin e APP-së, pasi është më e ulët se vlera minimale e përlllogaritur nga autoriteti kontraktor për realizimin e kësaj kontrate.

III.1.7. Referuar sa më sipër KPP gjykon se kuadri ligjor në fuqi ka vendosur tarifa minimale dhe maksimale për shërbimet e mbikëqyrjes dhe kolaudimit të cilat duhet të mbahen në konsideratë nga operatorët ekonomikë pjesmarrës në këto procedura. Komisioni sqaron se është detyrë e operatorëve ekonomikë të garantojnë që oferta e paraqitur të jetë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, me qëllim garantimin e një kontrate të sukseshme. Në rastin në fjalë, shoqëria “Erald-G” sh.p.k ka ofertuar me vlerë e cila rezulton të jenë nën vlerën minimale të lejuar të përlllogaritur nga autoriteti kontraktor për kryerjen e këtij shërbimi.

Sa më sipër, pretendimi i BOE ankimues “D&C Partners” sh.p.k & “Net-Group” sh.p.k qëndron.

Përse më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga BOE “D&C Partners” sh.p.k & “Net-Group” sh.p.k, për procedurën e prokurimit me Nr.REF-44482-11-21-2019, me objekt: “*Supervizion punimesh ndërtim i Urës së Zemblakut, Urës së Kaludhit, Urës së Dragotit, Urës së Leksit*”, me fond limit 1.738.185,65 lekë pa tvsh, zhvilluar ne daten 03.12.2019 nga autoriteti kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Erald-G” sh.p.k, duke e skualifikuar atë.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE “D&C Partners” sh.p.k & “Net-Group” sh.p.k, Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1947 Protokolli

Datë 27.12.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha